



Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete
Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

Raport Mujor – Shkurt 2009

Deklarata të pavend nga gjyqtarët shkelin të drejtën e të pandehurit për presupozim të pafajësisë

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) është e brengosur se në disa raste gjyqtarët kanë bërë vërejte të pavend të cilat nuk janë në pajtueshmëri me të drejtën e të pandehurit që ai të konsiderohet i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij. Kjo mund të shkel standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si dhe ligjin vendor.

Presupozimi i pafajësisë është parim elementar në procedurat penale si dhe gurthemel i të drejtës për gjykim korrekt. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut parasheh se “[ç]dokush i akuzuar për vepër penale do të konsiderohet i pafajshëm derisa të mos dëshmohet me ligj se ai/ajo është fajtor”.¹ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka urdhëruar që ky parim “kërkon, *inter alia*, që gjatë kryerjes së detyrave të veta, anëtarët e gjykatës nuk duhet të nisen nga ide paragjyquese se i akuzuari ka kryer veprën për të cilën akuzohet”.² Ngjashëm, sipas Ligjit të aplikuar të Procedurës Penale të Kosovës, “[c]ilido person i dyshuar ose i akuzuar për kryerje të veprës penale do të konsiderohet i pafajshëm derisa fajësia e tij/saj të mos përcaktohet me aktgjykim të formës së prerë nga ana e gjykatës”.³

Përkundër këtyre dispozitave të qarta ligjore, monitorimi i procedurave gjyqësore ka zbuluar se, në disa raste, gjyqtarët dështojnë të respektojnë të drejtën e të pandehurit për t’u konsideruar i pafajshëm.

Në një seancë gjyqësore të mbajtur në regjionin e Prizrenit në janar të vitit 2008, që përfshinte një të pandehur të akuzuar për sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare,⁴ avokati mbrojtës u ankua për një sërë shkeljesh procedurale të bëra në këtë rast. Duke iu përgjigjur parashtresave të mbrojtësit, kryetari i trupit gjykues vazhdimisht i thoshte atij që t’i “ruaj të gjitha ato vërejtje për ankesa”. Deklarata të tilla të kryetarit të kolegjit, të bëra para përfundimit të shqyrtimit kryesor, shfaqën paragjykim nga ana e tij sa i përket fajësisë së të pandehurit që paraqet shkelje të garancisë së presupozimit të pafajësisë.

¹ Neni 6(2), Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale.

² Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Barbera, Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës*, 10590/83, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 77.

³ Neni 3(1), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/26, 6 korrik 2003, me amendamentet e mëvonshme. Me 22 dhjetor 2008, Kosova ka shpallur Ligjin Nr. 03/L-003 mbi Ndryshimin dhe Përmirësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës Nr. 2003/26, që ka lënë Kodin në substancë njëjtë si ligji i vitit 2003, edhe pse është shtuar një pikë lidhur me marrëveshjet për deklaram të fajësisë, një nen lidhur me kohëzgjatjen e paraburgimit të urdhëruar nga policia ishte ndryshuar, dhe emri i ligjit ka ndryshuar. Tash e tutje, Kodi i Procedurës Penale i Kosovës.

⁴ Neni 317, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/25, 6 korrik 2003, me amendamentet e mëvonshme. Me 22 dhjetor 2008, Kosova ka shpallur Ligjin Nr. 03/L-002 mbi Ndryshimin dhe Përmirësimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës që ka lënë Kodin në substancë njëjtë si ligji vitit 2003, edhe pse është shtuar një paragraf që adreson dhe emri i ligjit ka ndryshuar. Tash e tutje, Kodi Penal i Kosovës.

Në një seancë gjyqësore në një rast të vrasjes së rëndë në dhjetor të vitit 2008,⁵ rasti në regjionin Prishtinë/Priština, është kërkuar nga një i pandehur që ai ta përshkruaj banesën e tij në të cilën ishte kryer krimi. Pasi që i pandehuri dha përshkrimin e tij, një gjyqtar nga kolegji ndërhyri në mënyrë publike dhe tha se i pandehuri ka harruar të shtojë se ai vet ishte prezent aty kur ndodhi krimi. Pasi që prezenca e të pandehurit në vend të ngjarjes ishte kundërshtuar nga ana e mbrojtjes dhe nuk ishte vendosur si fakt, vërejtja e gjyqtarit shprehi anshmëri të pabazuar ndaj të pandehurit dhe paragjykim të mundshëm kundrejt tij.

Në një tjetër seancë gjyqësore të mbajtur në regjion e Prizrenit në tetor 2007, që përfshinte një të pandehur të akuzuar për shkaktim të dëmit të përgjithshëm⁶ gjatë trazirave të marsit 2004, gjykata vendosi se ndjekja penale është e ndaluar për shkak të kufizimit statutor.⁷ Në vendimin e vet gjykata gjeti se “Përmes verifikimit të propozimit dhe pjesëve tjera të dëshmimeve të cilat ndodhen brenda shkresave të lëndës, është gjetur se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet, shkaktim të dëmit të përgjithshëm në shkellje të nenit 291 para. 1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK)”. Megjithatë, pasi që ndjekja penale është iniciuar pas skadimit të statutit të kufizimeve të caktuar me ligj, gjykata vendosi të hedh poshtë propozim akuzën dhe t’i jap fund procedurës penale”. Deklarata e cituar e gjykatës reflekton një opinion se i akuzuari është fajtor - kjo pa pasur rast që i pandehuri të mbrohet - dhe si e tillë bie në kundërshtim me garancinë për presupozim të pafajësisë.⁸

Si ligji vendor ashtu edhe ai ndërkombëtar parashohin se të pandehurit duhet të konsiderohen të pafajshëm për deri sa mos të provohet se janë fajtorë, pa marrë parasysh sa bindëse të jenë provat kundër tyre. Ky parim vendos detyrë mbi autoritetet që janë të përfshira në procedurat penale - në veçanti gjyqtarin, por edhe prokurorin⁹ dhe policinë¹⁰ – që të përmbahen, para së të merret aktgjykimi, nga të bërit ose të thënët publikisht diçka që do të nënkuptonte se i pandehuri veç se është dënuar.¹¹ Garancia për presupozim të pafajësisë mund të shkelet madje edhe në rastet kur zyrtarët publik, pa ndonjë gjetje

⁵ Neni 147, Kodi Penal i Kosovës.

⁶ Neni 291, Kodi Penal i Kosovës.

⁷ Sipas Nenit 468(1) lidhur me Nenin 316(1)3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

⁸ Gjykata Evropiane ka gjetur se “Presupozimi i pafajësisë do të shkelet nëse, para se të dëshmohet me ligj se i akuzuari është fajtor, dhe në veçanti, pasi ai të mos ketë pasur mundësinë të ushtrojë të drejtën e tij për mbrojtje, një vendim gjyqësor lidhur me të reflekton opinionin se ai është fajtor. Kjo mund të qëndrojë edhe në mungesë të ndonjë gjetje formale: mjafton se ka ndonjë arsyetim që sugjeron që gjykata e konsideron të akuzuarin fajtor”. Shih *Minelli kundër Zvicrës*, 8660/79, Aktgjykimi i 25 marsit 1983, paragrafi 37. Shih gjithashtu *Lutz kundër Gjermanisë*, 9912/82, Aktgjykimi i 25 gushtit 1987, paragrafët 59-60.

⁹ Shih *Daktaras kundër Letonisë*, 42095/98, Aktgjykimi i 17 janarit 2001, paragrafët 42-44.

¹⁰ Shih *Allenet de Ribemont kundër Francës*, 15175/89, Aktgjykimi i 10 shkurtit 1995, paragrafi 41.

¹¹ Shih *Austria kundër Italisë*, Aplikacioni në GjEDNj nr. 788/60.

zyrtare, mendojnë ose sugjerojnë përmes ndonjë arsytimi se i pandehuri konsiderohet fajtor.¹²

Për atë që u tha më lartë, OSBE rekomandon që:

- Autoritetet gjyqësore dhe të rendit gjithmonë të respektojnë plotësisht të drejtën e të pandehurit për ta konsideruar të pafajshëm gjatë rrjedhës së procedurës penale dhe të përmbahen nga çfarëdo deklarate që mund të bie në kundërshtim me presupozimin e pafajësisë derisa ai/ajo të mos shpallet fajtor nga gjykata.

Dispozitat kalimtare të përfshira në Ligjin mbi Procedurën Kontestimore të vitit 2008 i kontribuojnë vonesave në rastet civile edhe ashtu të vonuara

Me 6 tetor 2008, gjykatat në Kosovë filluan të zbatojnë një ligj të ri mbi procedurën civile.¹³ Edhe pse shumë dispozita mbeten të njëjta ose në substancë të ngjashme me Ligjin e Procedurës Kontestimore të vitit 1982,¹⁴ dispozitat kalimtare të Ligjit të zbatueshëm të Procedurës Kontestimore të vitit 2008 kërkojnë nga gjykatat që në rastet në shkallë të parë t'i përdorin dispozitat nga ligji i ri në të gjitha procedurat që janë në punë, madje edhe në ato që janë iniciuar para datës kur ligji ka hyrë në fuqi.¹⁵

Gjatë procedurave paraprake, në të cilat nuk është mbajtur asnjë seancë e shqyrtimit kryesor, Ligji mbi Procedurën Kontestimore i vitit 2008 kërkon nga gjykatat që të “revokojnë urdhrin në bazë të së cilit është thirrur seanca[paraprake] dhe [...] të kërkojnë nga paditësi që të prezantojë padi me shkrim bazuar në dispozitat e këtij ligjin.”¹⁶ Në të shumtën e rasteve, paditësi veç se ka parashtruar padinë me shkrim. Megjithatë, shpesh në gjykatat e Kosovës, i padituri do të parashtronte përgjigje me gojë ndaj padisë së prezantuar nga paditësi, gjatë një seance gjyqësore. Sipas Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të vitit 2008, i padituri duhet të prezantojë përgjigje me shkrim ndaj padisë brenda 15 ditëve pasi që padia të jetë parashtruar në gjykatë.¹⁷

Përderisa palët shpesh presin me vite që rasti i tyre të arrijë seancën e parë të shqyrtimit kryesor pranë gjykatave të Kosovës, të kërkohet që procedura të rifilloj bazuar në rregullat e reja procedurale mund edhe më tej të vonojë rastet.

Vonesat qenësore në procedurat civile ngrisin shqetësime lidhur me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Neni 6(1) i Konventës Evropiane për të Drejtat e

¹² Shih *Allenet de Ribemont kundër Francës*, cituar më lartë, paragrafi 35. Shih po ashtu *Daktaras kundër Letonisë*, të cituar më lartë, paragrafi 41.

¹³ Ligji Nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore, Gazeta Zyrtare e Kosovës, 20 shtator 2008 (tash e tutje, Ligji mbi Procedurën Kontestimore i vitit 2008).

¹⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë 4/1977, 36/1980, dhe 66/1982 (12 shkurt 1982) (tash e tutje Ligji mbi Procedurën Kontestimore i vitit 1982).

¹⁵ Neni 532, 2008 Ligji mbi Procedurën Kontestimore.

¹⁶ *Id.* neni 532.2.

¹⁷ *Id.* neni 395.1.

Njeriut garanton të drejtën për “grykim publik e korrekt brenda kohës së arsyeshme.” Një nga qëllimet e së drejtës për grykim brenda kohës së arsyeshme është që të “mbrojtë [palët] kundër vonesave të tej-zgjatura procedurale” dhe shmangies për ta lënë personin “të qëndroj për kohë të gjatë në gjendje pasigurie lidhur me fatin e tij.”¹⁸ Veç kësaj, nënvizon “rëndësinë e ndarjes së drejtësisë pa vonesa që do të mund të rrezikonte efikasitetin dhe besueshmërinë e saj.”¹⁹

OSBE ka monitoruar rastet në të cilat zbatimi i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore i vitit 2008 duket të ketë shkaktuar vonesa shtesë. Për shembull:

Në një rast të parashtruar në regjionin Prishtinë/Priština me 11 korrik 2007, paditësi kërkoi anulimin e vendimit të një komisioni për përzgjedhje të entitetit publik që ka refuzuar aplikacionin e tij për punësim. Seanca e parë dëgjimore nuk është mbajtur deri me 8 tetor 2008, dy ditë pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Procedurës Kontestimore të vitit 2008. Në atë seancë, gjykata kërkoi nga i padituri që të prezantojë disa dëshmi në seancën që do të mbahet me 13 nëntor 2008. Megjithatë, në seancën e 13 nëntorit 2008, gjykata revokoi urdhrin e vet të mëparshëm duke cituar Ligjin mbi Procedurën Kontestimore të vitit 2008. Në veçanti, gjykata kërkoi nga i padituri që të parashtronte përgjigje me shkrim ndaj padisë së ngritur nga ana e paditësit brenda 15 ditëve duke u thirrur në nenet 395 dhe 396 të ligjit të 2008-ës. Edhe pse gjykata përfilli kushtet e tij, zbatimi i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore vetëm kontribuoi në vonesë të rastit edhe ashtu të vonuar.

Në një rast të pronës martesore të parashtruar pranë një gjykate në regjionin Prishtinë/Priština me 18 korrik 2007, seanca e parë dëgjimore nuk ishte caktuar deri në qershor të vitit 2008. Gjykata shtyu atë seancë për shkak të mungesës së avokatit të të paditurit. Seanca e radhës ishte shtyrë gjithashtu për shkak se gjykata kishte dështuar ta ftojë paditësin në mënyrë të rregullt. Përfundimisht, në seancën e katërt të mbajtur në nëntor 2008, gjykata revokoi urdhrin e vet për caktim të po asaj seance dhe urdhëroi të paditurin të parashtronte përgjigje me shkrim, duke u thirrur në nenin 532.2 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të vitit 2008.

Përveç rasteve të monitoruara, gjyqtarët kanë shprehur shqetësimet e tyre se zbatimi i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore i vitit 2008 mund t'i kontribuojë vonesave. Gjatë bisedave me monitoruesit e OSBE-së që nga tetori 2008, gjyqtarët posaçërisht kanë cekur se kushti i paraparë sipas nenit 532 i Ligjit të Procedurës Kontestimore të vitit 2008 për të rifilluar procedurat, shkaktonte vonesa në disa raste.

Në mënyrë që të shmangen vonesat shtesë në rastet civile dhe të punohet në pajtueshmëri më standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, OSBE rekomandon që:

¹⁸ *H. kundër Francës*, 10073/82 Aktgrykim, 24 tetor 1989, paragrafi 58.

¹⁹ *Stögmüller kundër Austrisë*, 1602/62, Aktgrykim, 10 nëntor 1969, paragrafi 5.

- Ligjvënësit duhet të ndryshojnë Ligjin mbi Procedurën Kontestimore të vitit 2008 në atë mënyrë që të kërkojnë që rastet të iniciuara para shpalljes së tij të vazhdojnë të procedohen sipas Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të vitit 1982.